

në ndonjë vend më të sigurt. Shkuan me një furgon te vendi i quajtur *Proni i Bukës*, në fund të fshatit. Ditën tjetër, [22.09.1998] Muhamedi dhe Hamidja u kthyen në shtëpi që ta lëshonin bagëtinë nga ahuri. Përderisa gjendeshin në oborr, vërejtën se forcat serbe kishin filluar të zhvendoseshin nëpër fshat. Hamidja u kthye menjëherë te furgoni, ndërkaq Muhamedi ndenji për pak që të kryente edhe diçka tjetër. Kur arriti te *Proni i Bukës*, Hamidja vërejtë se policia serbe e ka zënë Muhametin. Burrat u larguan menjëherë. Pranë furgonit kanë mbetur vetëm Hamidja me fëmijët. Policët e sollën Muhametin te furgoni. I bënë pyetje për vendndodhjen e burrave të tjerë, ndërsa ai përgjigjej se nuk dinte. Nuk vonoi shumë dhe policët e morën Muhametin me furgon dhe u nisën në drejtim të fshatit *Krasaliq/Krasalić*. Pas pak, Hamidja i dëgjoi disa të shtëna rafali. Një ditë më vonë, Aziz Hajrizi nga Krasaliqi/Krasalić e ka njoftuar familjen se e kishte gjetur trupin e pajetë të Muhametit në një livadh në fshatin e tij. Familjarët e kanë varrosur Muhametin në varrezat e Beçiqit/Bečić. Nga fundi i muajit gusht të vitit 2000, ekspertet ndërkombëtare të mjekësisë ligjore e kanë bërë zhvarrimin e mbetjeve mortore të Muhametit. Familjarët e kanë rivarrosur trupin e Muhametit më 6.10.2000 në varrezat e Beçiqit/Bečić.

Burimet: deklarata H.I, FDH-19371; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256; fotografi, FDH-24790.

Rrustem (Fetah) Karagja

(1948, shqiptar nga Çikatova e Vjetër/Staro Çikatovo, komuna e Gillogocit/Glogovac, bujk, katër fëmijë)

Rrustemi me familje e kanë braktisur Çikatovën e Vjetër/Staro Çikatovo në fund të muajit maj të vitit 1998. Policia serbe ishte e pozicionuar në fabrikën e *Ferromikelit* në Gillogoc/Glogovac. Në datën 22.09.1998, ofensiva e madhe e forcave serbe e ka përfshirë edhe familjen Karagja, e cila në ato çaste ndodhej në pyll përmbi fshatin Gradicë/Gradica [Çiçavicë/Čičavica]. Për shkak të tolllovisë që u krijua, Rrustemi u

nda nga familja dhe ka shkuar në drejtim të Krasmirocit/Krasmirovac. Pas tri ditësh, djali i Rrustemit, Ferki Karagja, i cili ishte ushtar i UÇK-së, e ka gjetur trupin e Rrustemit në një kënetë, e cila gjendej në pyllin e fshatit **Krasmiroc/Krasmirovac**. Në trup shiheshin qartazi plagët nga plumbat. Me ndihmën e ushtarëve të UÇK-së, Ferkiu e ka varrosur Rrustemin jo larg vendit të vrasjes. Pas përfundimit të luftës, më 7.11.1999, trupi i Rrustemit u rivarros në varrezat e Çikatovës së Vjetër/Staro Čikatovo.

Burimet: deklarata B.K, FDH-20366; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Murat (Muharrem) Haliti

(3.05.1964, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, arsimtar, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Fatmir (Hajrush) Ahmeti

(14.09.1975, shqiptar nga Lubavecit/Ljubovac, komuna e Skënderajt/Srbica, teknik, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Murati e ligjëronte lëndën e historisë në shkollën *Frank Bardhi* në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Ka qenë komandant i shtabit lokal në fshatin e lindjes së Lubavecit/Ljubovac. Fatmiri ka qenë ushtar në të njëjtin njësit. Forcat serbe e vendosën rrethimin e Lubavecit/Ljubovac më 22.09.1998. Rreth orës 8:00, nga një kodër përmbi fshat, filluan me bombardimin e shtëpive të fshatit. Popullata e braktisi shpejt fshatin, shumica me traktorë. Murati dhe Fatmiri me njësitin e vet e mbanin pozicionin te vendi i quajtur *Te Çezma e Vojteshit/Vojtesha çesma*. Nga ora 13:00, Murati dhe Fatmiri u nisën drejt Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze që tu ndihmonin njësiteve të UÇK-së atje. Nuk u kthyen në mbrëmje. Dy ditë më vonë, i ati dhe e ëma e kanë gjetur trupin e pajetë të Muratit, si dhe atë të Fatmirit në pyll në mes të **Lubavecit/Ljubovac** dhe Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze. Varrimi i tyre u krye më 24.09.1998 në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata O.H, FDH-32797; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Identity of Five Other Albanians, Killed in Drenica, Made*